



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit  
Nacionalna Kancelarija Revizije  
National Audit Office

# RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË FONDEVE NË MIRËBESIM PËR VITIN 2022

Prishtinë, qershor 2023

# PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

# 1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Fondeve në Mirëbesim për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2022, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.<sup>1</sup>

## Opinion i pamodifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Fondeve në Mirëbesim (FM), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera<sup>2</sup>, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2022.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të Fondeve në Mirëbesim, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

## Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

## Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Fondeve në Mirëbesim kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

**Baza për konkluzion**

B1 Mos respektimi i afateve për pagesën e detyrimit financiar në 36 raste në vlerë financiare prej 536,943€.

*Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë*

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

**Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore**

Drejtori Menaxhues i Agjencisë Kosovare të Privatizimit është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Drejtori Menaxhues i Agjencisë Kosovare të Privatizimit është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Drejtori Menaxhues i Agjencisë Kosovare të Privatizimit është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Fondeve në Mirëbesim.

**Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë**

Menaxhmenti i Fondeve në Mirëbesim është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Fondeve në Mirëbesim në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.<sup>3</sup>

**Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve**

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Fondeve në Mirëbesim me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Fondeve në Mirëbesim.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

## 2 Gjetjet dhe rekomandimet<sup>4</sup>

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve. Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Ky raport ka rezultuar me tetë (8) rekomandime, prej tyre pesë (5) janë rekomandime të reja, dy (2) të përsëritura dhe një pjesërisht i përsëritur.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

## 2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

### Çështja B1 - Mos respektimi i afateve për pagesën e detyrimit financiar

#### Gjetja

Neni 8, pika 5 e Rregullores nr. 06/2022 për shitjen direkte të aseteve, përcakton "Nga dita e njoftimit të palës për miratimin përfundimtar të shitjes nga Bordi i Drejtorëve, detyrimi i palës për pagesën e çmimit kontraktues është 60 (gjashtëdhjetë) ditë, me përjashtim të rasteve për të cilat pagesat kontraktohen në faza periodike. Nëse pagesa nuk realizohet brenda afatit të cituar si më sipër dhe pala ofron arsye bindëse lidhur me vonesën, atëherë me pëlqimin e Drejtorit Menaxhues, palës do t'i ofrohet një afat shtesë prej 30 ditësh lidhur me përmbushjen e obligimeve për pagesë. Nëse as pas kalimit të këtij afati nuk realizohet pagesa rasti i përcjelllet Bordit për vendimmarrje lidhur me zgjatjen e afatit apo pezullimin e procedurës".

Në gjashtë (6) raste kemi vërejtur që, AKP nuk kishte arritur të arkëtoj të hyrat nga shitja e aseteve me negociim direkt në afatet kohore të përcaktuara me rregullore. Vlera e tyre ishte 18,967€. Më tej, sipas shënimeve të ofruara nga zyrtarë përgjegjës në AKP si dhe nga regjistri i llogarive të arkëtueshme, ekzistojnë edhe 36 raste të tilla në vlerë financiare prej 536,943€ për të cilat ka përfunduar afati i pagesave dhe nuk ju është ofruar edhe një afat shtesë për përmbushje të obligimeve për pagesë.

Kjo ka ndodhur për shkak të mos respektimit të afateve nga palët dhe mos marrja e ndonjë veprimi nga Kryesuesi i Njësisë për të informuar nivelet relevante sipas hierarkisë/organogramit për caktimin e afateve kohore shtesë lidhur me përmbushjen e detyrimeve financiare.

#### Ndikimi

Mos respektimi i afateve ligjore nga palët ndikon që rastet të mbesin pezull dhe mos të merren si të finalizuara, po ashtu dëmtojnë interesat ndaj AKP-së dhe arritje të objektivave të saj.

#### Rekomandimi B1

Bordi i Drejtorëve duhet të shtojë kontrollin e brendshëm lidhur me arkëtimin e të hyrave nga shitja e aseteve me negociim direkt si dhe të ndërmerrë veprimet e duhura në rastet kur pagesat nuk arkëtohen brenda afateve.

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

## 2.2 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

### 2.2.1 Vendimet e gjykatave/përmbauesve (depozita dhe taksa)

Gjatë vitit 2022, janë realizuar pagesat për vendimet e gjykatave në vlerë prej 5,366,632€, ndërsa në vitin 2021 ishin 213,165€. Rritja e shpenzimeve kundrejt vitit 2021 është kryesisht rezultat i ekzekutimit të pagesës nga përmbauesi privat nga NSH në likuidim Newco LLamkos Steel. Vendimet e gjykatave/përmbauesve janë pagesat ndaj palëve të jashtme dhe kompensimi i tarifës administrative.

#### Çështja A1 - Shpenzime shtesë si rezultat i mos pagesës me kohë të vendimit gjyqësorë

##### Gjetja

Me datë 07.03.2022, Tribunali Ndërkombëtar i Arbitrazhit e urdhëron AKP-në që t'i paguajë rimbursimin e shpenzimeve të Tribunalit, si dhe rimbursimin e shpenzimeve ligjore dhe shpenzimet e tjera të shkaktuara, me normën vjetore 4% nga data e vendimit deri në pagesën e plotë.

Nga shqyrtimi i pagesave përmes vendimeve gjyqësore kemi vërejtur se obligimi ligjorë nuk ishte paguar me kohë dhe si rezultat i kësaj janë paguar shpenzimet e interesit në vlerë prej 7,509€. Kjo si rezultat i asaj që për shpenzimet e Tribunalit Ndërkombëtar të Arbitrazhit në vlerë prej 406,890€ si rimbursim i shpenzimeve të Tribunalit, si dhe shumën 1,350,086€ si rimbursim i shpenzimeve ligjore. Bordi i Drejtorëve merr vendim me datë 30.03.2022 për procedim të pagesës përderisa departamenti i financave me datë 14.04.2022 parashton kërkesë për nënshkrim të urdhër transferit bankarë me llogaritje të kamat-vonesës deri me 15.04.2022.

Kjo ka ndodhur për shkak se vendimi i aprovuar me datë 30.03.2022 nga ana e Bordit, nuk është dërguar me shkrim deri me datë 12.04.2022 tek Autoriteti i Likuidimit për ta përgatitur memon dhe kërkesën për pagesë tek departamenti i financave.

##### Ndikimi

Pagesat e interesit për shkakë të vonesave të procedimit të pagesave ndikojnë në rritjen e pa arsyeshme të shpenzimeve të Agjencisë.

##### Rekomandimi A1

Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë që obligimet që dalin nga vendimet gjyqësore të paguhen në kohën e duhur dhe brenda afateve në mënyrë që të evitohen shpenzimet shtesë.

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)



## 2.2.2 Të hyrat nga shitja e aseteve

Gjatë vitit 2022, janë realizuar të hyra nga shitja në vlerë prej 6,152,060€, ndërsa në vitin 2021 ishin 6,096,934€. Të hyra nga shitja e aseteve janë pagesat e pranuar lidhur me privatizimin dhe likuidimin e aseteve. Nga muaji mars 2020 deri në qershor 2022 nuk ka pasur valë të shitjeve.

### Çështja A2 - Mos respektimi i afatit kohor gjatë procedurës për përmbylljen e kontratës

**Gjetja** Neni 8.4 i Rregullores nr. 06/2022 për shitjen direkte të aseteve, përcakton "Procedura për përmbylljen e kontratës me parashtruesin (nga cilësia e tij si palë kontraktuese) do të përmbyllet në afatin kohor prej 30 ditësh, nga dita e përbushjes së detyrimeve kontraktuese (pagesës)".

Në një rast kemi vërejtur vonesë në dhënien e kontratës duke mos respektuar afatin kohor prej 30 ditësh. Shitja e parcelës së NSH "Lavërtaria" në vlerë prej 2,060€, pala kishte përbush detyrimin financiar në 28.04.2022, mirëpo kontrata ende nuk i ishte dorëzuar blerësit, për me tepër kemi vërejtur se blerësi kishte paguar 255€ me tepër se obligimi financiar dhe mjetet nuk ju kanë kthyer ende.

Kjo ka ndodhë për shkak të mos funksionimit të kontrolleve të brendshme tek departamenti i shitjes.

**Ndikimi** Mos respektimi i afateve në dorëzimin e kontratave tek palët ndikojnë në vonesa në përmbylljen e procesit të likuidimit të NSH-ve, që bart me vete edhe kosto të përmbylljes në tërësi të procesit të likuidimit.

**Rekomandimi A2** Bordi i Drejtorëve duhet të forcojë kontrollet e brendshme duke siguruar se procedura për përmbylljen e kontratës të kryhet në afatin kohor të paraparë prej 30 ditësh.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

### 2.2.3 Të hyrat nga qiraja

AKP realizon të hyra nga asetet e dhëna me qira të lokaleve, tokave bujqësore, pikave të shitjes të derivateve, depove, etj. Gjatë vitit 2022 këto të hyra ishin në vlerë prej 4,842,279€, me një ndryshim prej 5.62% në raport me vitin 2021 që kanë qenë 5,130,354€.

#### Çështja A3 - Parregullsi në menaxhimin e qirave

##### Gjetja

Bazuar në kontratat e qirasë pika A qiramarrësi pajtohet që të marr me qira nga qiradhënësi objektin/token me sipërfaqe të përcaktuar/ precizuar në m<sup>2</sup>/ari/hektar. Gjithashtu edhe në piken 1.2 shprehimisht potencohet me shkrim. Kontrata do të jetë një vjeçare/ gjashte muaj, duke filluar me datë të caktuar dhe e cila përfundon me datë të përcaktuar në këtë nen. Po ashtu në nenin 3.2 Qiramarrësi pajtohet që ti paguaj shumat me pagesa të rregullta paraprake mujore, duke filluar me pagesën e caktuar në fillimin e kësaj kontrate të qirasë.

Në dy (2) raste kemi vërejtur se kontratat përmbajnë gabime sa i përket afateve të kohëzgjatjes së kontratave krahasuar me datat e përcaktuara në kontratë. Në njërin rast, kontrata e lidhur me 01.08.2022 përcakton se periudha fillestare e kontratës së qirasë do të jetë një vjeçare, duke filluar nga 01.08.2021 deri më 31.07.2023 përderisa nëse i referohemi datave periudha e kontratës është dy vjeçare. Rasti tjetër kontrata e lidhur me 17.03.2022 me kohëzgjatje 12 muaj, duke filluar nga 01.04.2022 deri me 30.09.2022 nëse i referohemi datave periudha e kontratës është vetëm 6 muaj.

Në një rast kontrata përmbante sipërfaqen gabimisht krahasuar me shpalljen publike. Në kontratën e lidhur me 01.08.2022 në pjesën A, qiramarrësi merr me qira hollin e prodhimit të telit me sipërfaqe prej 8,411m<sup>2</sup> ndërsa në njoftimin për shpallje publike përveç hollit prej 8,411m<sup>2</sup> përfshihet edhe pjesa e aneksit të objektit kryesore në sipërfaqe 2,073m<sup>2</sup>.

Në një rast tek NSH PRZ026 "Farmakos - Prizren" (në likuidim) kontrata e qirasë me datë 11.03.2022, kemi vërejtur se sipërfaqja e ndërtesës në total e specifikuar në kontratë nuk përputhet me sipërfaqet e detajuara të njëjësive në shfrytëzim të kësaj ndërtese që rezulton me diferencë prej 77m<sup>2</sup> më pak se sipërfaqja e ndërtesës në total.

Në një rast tek Ndërmarrja "Grafike Rilindja" nuk na është ofruar kontrata e qirasë apo aneksi i kontratës për vitin 2022 me pretekstin se nuk ka kontrata të lidhura me operatorin për këtë periudhë, mirëpo qiraja është faturuar duke u bazuar në kontratën e lidhur midis NSH dhe OE para se NSH të hyj në likuidim, kjo për shkak të kontesteve me qiramarrësin për shkak të pranimit/mospranimit të investimeve.

Ndërsa në 37 raste në "Aneks kontratat e lidhura" kemi vërejtur se datat e nënshkrimit të aneks kontratave (të protokoluara) janë më vonë se sa fillimi i periudhës së qirasë të përcaktuar në aneks/kontrata. Kryesisht vonesat janë në datën e protokolimit krahasuar me periudhën e fillimit të aneks kontratave të cilat mund të ndikojnë edhe faturimin e qirasë për shkak të këtyre vonesave.

Gabimet e evidentuar kanë rrjedh si pasoj e mosfunksionimit të kontrolleve të vendosura, nga nivelet përkatëse.

**Ndikimi** Parregullsitë në përmbajtjen e kontratave rezultojnë me gabime që mund të ndikojnë në paqartësi në rast kontesti për ti realizuar të drejtat apo detyrimet e palëve që burojnë nga këto kontrata. Kjo mund të vështirësoj pajtimin e palëve në rast të vazhdimit të këtyre kontratave, për shkak se rregullimi i kushteve të këtyre kontratave mund të pasoj me ndryshim të sipërfaqeve apo ndikoj në vet shumën e qirasë si objekt i kontratës. Faturimet e pa rregullta, rezultojnë me kontrolle jo adekuate apo parregullsi në faturimin e cila nuk i jep të drejt qiradhënësit në realizmin e të hyrave me kohë.

**Rekomandimi A3** Bordi i Drejtorëve të sigurojë se kontrollet janë funksionale me rastin e lidhjes së kontratave, dhe kontratat e identifikuar me gabime përmbajtjesore duhet të korrigjohen nga nivelet përkatëse.

### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

#### Çështja A4 - Parregullsi në menaxhimin e pronave të Ndërmarrjeve Shoqërore (NSH-ve) në likuidim

**Gjetja** Neni 9 Lidhja e kontratave, i Rregullores nr. 05/2020 për qiradhënie e asetëve të NSH përkatësisht pika 5 përcakton që qiramarrësi i asetëve që nuk kanë karakter specifik nuk mund të bëjë ndonjë ndryshime strukturor apo dekorativ në lokalin afarist pa miratimin paraprak me shkrim nga AKP-ja si administrues i asetit. E njëjta situatë është parapa edhe në kontrata tek NSH-të në likuidim, përkatësisht në nenin 2.6/2.7 të kontratave bazë të lidhur nga AKP/AL si qiradhënës dhe personave fizik apo juridik si qiramarrës.

Në katër (4) raste të qirave, tek NSH "Grandi SHPK" në likuidim, me datë 01.08.2022 janë bërë ndryshim/plotësimet e kontratave bazë duke ndryshuar sipërfaqen dhe çmimin e qirasë për muaj. Palët kontraktuese janë pajtuar që ndryshimet të aplikohen retroaktiv nga 01.01.2022. Kjo sipas zyrtarëve përgjegjës në AKP, është bërë për shkak se qiramarrësit kanë intervenuar dhe objektet janë zgjeruar duke rritur sipërfaqen. Mirëpo, për ndryshimet e bëra në strukturën e objekteve (sipërfaqeve), nuk është marrë miratimi paraprak për ndryshim të sipërfaqeve.

Kjo ka ndodhur për shkak se NSH ka dështuar në të drejtën për të kontrolluar lokalin, objektin/tokën në ndryshimin e bërë me data të caktuara. Këto ndryshime nuk dihet se kur kanë ndodh edhe pse në mënyrë retroaktive janë ngarkuar nga muaji janar i vitit 2022.

**Ndikimi** Përveç dështimit të kontrolleve dhe anashkalimit të procedurës për miratim nga Bordi për ndryshim strukturor të objekteve të dhëna me qira, kjo vështirëson menaxhimin e të hyrave dhe ngarkon OE/qiramarrësit me obligime retroaktive apo vështirëson funksionimin normal të këtyre bizneseve. Të njëjtit operator vazhdojnë të mbesin si obligues të qirasë apo janë të evidentuar edhe tek llogaritë e arkëtueshme si biznese me vonesë për pagesën e qirasë.

**Rekomandimi A4** Bordi i Drejtorëve të sigurojë se kontrollet e vendosura janë funksionale dhe çdo ndryshim në strukturën e objektit të dhënë me qira paraprakisht duhet ti paraprij miratimi i Bordit, me qëllimin të menaxhimit të këtyre ndryshimeve në veçanti kur këto rinovime janë objekt i ndryshimit të kontratave.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

## 2.2.4 Mallra dhe shërbime

Gjatë vitit 2022 vlera e pagesave për mallra dhe shërbime të NSH-ve ishte 1,800,553€, ndërsa në vitin 2021 ishin 2,325,690€. Ulja e shpenzimeve kundrejt vitit 2021 është kryesisht rezultat i ndërprerjes të angazhimeve të OSH-ve por edhe të pagesave të të arbitrazhit ndërkombëtar që janë bërë në vlerën prej 405,080€ për rastin e Ndërmarrjes së Re Sharrcem.

### Çështja C1 - Dobësi në angazhimin e Ofruesve të shërbimeve (OSH-të)

- Gjetja** Sipas rregullores 06/2020 për angazhimin e ofruesve të shërbimeve në procesin e likuidimit të NSH, neni 4 kostoja e angazhimit të OSH, pika 1.1 për detyrat sipas nenit 2.2 dhe 2.23 të kësaj rregulloreje është 450€; dhe 1.2 Për detyrat sipas nenit 2.2.4 të kësaj rregulloreje kostoja është 330€.
- Gjatë auditimit kemi vërejtur se pagat e ofruesve të shërbimeve janë paguar nga 200€ - 750€, e cila bje ndesh me rregulloren për caktimin e kostove të pagave të OSH-ve.
- Arsyetimi për caktimin më të lartë të pagave sipas zyrtarëve të AKP-së, është bërë tek rastet e angazhimit të OSH-ve në periudha të mëparshme (para se të hyj në fuqi rregullorja), dhe tek ish/punëtorët që janë angazhuar si OSH është ruajtur e njëjta pagë apo paga ekzistuese para se NSH-ja të hyjë në likuidim, apo kur NSH-të në likuidim gjenerojnë të hyra.
- Ndikimi** Kostot e pagesës për ofruesit e shërbimeve që nuk përputhen me rregulloren reflektojnë trajtim jo të drejt apo të barabartë të kontraktorëve që ofrojnë shërbimet të njëjta krahasuar me kostot e ndryshme të pagesës.
- Rekomandimi C1** Bordi i Drejtorëve të sigurojë se kostot e angazhimit sipas rregullores janë duke u zbatuar, duke pas parasysh pagesën e njëjtë për shërbimin e njëjtë.

### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

## 2.2.5 Shpenzimet komunale

Pagesat për shërbime publike gjatë vitit 2022 ishin 206,836€, krahasuar me vitin e kaluar, këto shpenzime janë zvogëluar për 26%. Ulja e shpenzimeve komunale kundrejt vitit 2021 është kryesisht si rezultat i kompensimit të tarifës administrative që është më e madhe në vitin 2021 në krahasim me vitin 2022. Këto shpenzime kanë të bëjnë me pagesat për shpenzimet komunale, pagesa këto që bëhen për ndërmarrjet shoqërore në tranzicion dhe në likuidim.

### Çështja A5 - Menaxhimi i dobët i shpenzimeve komunale

#### Gjetja

Neni 3 i marrëveshjes për shërbimin e mbeturinave/kjo marrëveshje do të jetë e vlefshme për periudhë të caktuar kohore duke filluar nga data (e përcaktuar në këtë marrëveshje) deri me datën (po ashtu të përcaktuar në këto marrëveshje). Po ashtu te neni 4 i marrëveshjes faturime mujore do bëhet në bazë të sasisë së kontejnerëve të zbratur në hapësirat e 3 tregjeve sipas pjesës a dhe b (të cilat do të aplikohen në çoftë se do të kërkohen sipas nevojës). Neni 5.1 i kontratës për pranimin e shërbimit (nënshkrimi të fletë dëshmisë) caktohet ofruesi i shërbimit - punëtori i sigurimit kushdo që është në ndërrim për tre (3) tregjet.

Dy marrëveshje për shërbimin e mbeturinave midis AKP/AL, dhe operatorit ekonomikë për pastrimin e mbeturinave (KRM Pastrimi) për NSH Tregun, janë lidhur me vonesë me 13.01.2022 për periudhën prej 01.01.2022 deri më 31.06.2022, dhe marrëveshja në vazhdim për periudhën nga 01.07.2022 deri më 31.12.2022 është lidhur me datë 02.08.2022.

Më tej, lista e evidencave nuk përputhet me faturimin për muajin shkurt 2022 në vlerë prej 8,849.52€. Diferencat janë tek zbrazia e kontejnerëve dhe shërbimin me ngarkues  $41h \cdot 43.2\text{€} = 1,771\text{€}$ .

Kjo ka ndodhur për shkak të mosfunksionimit të kontrolleve, edhe për kundër që AKP/AL ka tentuar të bëjë përmirësime duke kthyer faturat në disa raste dhe duke korrigjuar, përsëri mangësitë janë evidente.

#### Ndikimi

Mos përputhja e faturimit me listën e evidencave mund të ketë pasojë në vlerësimin e drejtë të pagesave apo realizimin e pagesave të pa rregullta në mungesë të dëshmive. Vonesat në lidhje të marrëveshjeve apo aneks/kontratave, mund të përcillen me dobësi në menaxhimin e këtij procesi.

#### Rekomandimi A5

Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë se kontrollet e vendosura janë funksionale duke lidhur me kohë kontratat. Si dhe duhet të sigurojë se para ekzekutimit të pagesës, pranimet e shërbimit janë kontrolluar dhe evidencat janë të plota dhe të sakta duke reflektuar në faturim sipas këtyre evidencave.

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

## 2.2.6 Të arkëtueshmet

Llogaritë e arkëtueshme kanë të bëjnë me pjesët e papaguara nga valët e privatizimit/likuidimit dhe shitjeve përmes negocimit direkt dhe qiratë apo të hyra të tjera nga asetet e NSH-ve. Vlera e llogarive të arkëtueshme nga shitja e asteve e prezantuar në PFV për vitin 2022 ishte 8,692,937€, përderisa në vitin 2021 ishin 16,985,925€. Nga muaji qershor 2022 është filluar me procesin e valëve të shitjes dhe llogaritë e reja gjatë vitit kanë të bëjnë me valën e fundit të shitjes dhe që është ende në procedurë të procesit për nënshkrimin/realizimin e kontratave.

### Çështja B2 - Arkëtimi me vonesë i të hyrave nga qiratë

<b>Gjetja</b>	<p>Bazuar në kontratat e lidhura për qiranë midis qiradhënësit AL/AKP dhe OE për shfrytëzimin e pronave (objekte, toka) të NSH-vë në likuidim, qiramarrësi është i obliguar dhe pajtohet të paguaj shumat me pagesa të rregullta paraprake mujore duke filluar me pagesën e parë të caktuar në fillimin e kontratës së qirasë dhe deri në masën që është e zbatueshme me pagesën mujore në vijim të caktuar në të njëjtën ditë të muajit vijues. Qiramarrësi brenda 5 ditëve të punës që nga pranimi i një fature të zbatueshme nga qiradhënësi (apo ndryshe) nga kosto vijuese nga ngarkesat. AKP mundë të pajtohet me kërkesën me shkrim nga qiradhënësi për të shfrytëzuar afatet e ndonjë pagesë sipas kësaj Kontrate të qirasë në situatën të jashtëzakonshëm dhe pajtueshmëri të tilla do të konsiderohen të vlefshme vetëm nëse qiradhënësi pajtohet me shkrim për këtë. Dështimi i kontratës parasheh shkeljen nga qiramarrësi për të përmbushur kushte e kësaj kontrate, paaftësia e pagesës nga ana e qiramarrësit apo parashttrimi dhe dorëzimi në gjykata i ndonjë peticioni mbi falimentimin kundër qiramarrësit.</p> <p>Gjatë testimit të llogarive të arkëtueshme për të hyrat nga qiratë, kemi testuar 62 mostra dhe si rezultat i testimit të këtyre mostrave kemi vërejtur se vetëm gjashtë (6) raste ishin pagues të rregullt përderisa rastet tjera kishin obligime financiare të papaguara. Kryesisht vonesat fillojnë nga një muaj deri në një vit mirëpo ka edhe borxhe të pa inkasuar nga viti 2015/2016 e tutje. Për më tepër vetëm në 15 raste qiramarrësit janë dërguar në përmbarrim apo gjykata.</p> <p>AKP/Fondi ka ndërmarr masa duke i dërguar disa qiramarrës në procedura përmbarrimore, dhe disa raste në gjykatë (të dërguar edhe nga NSH), mirëpo vlera e borxheve mbetet ende e lartë në mungesë të marrjes së masave të duhura (aplikimit të mekanizmave sipas nenit 8 të kontratës apo masave korigjuese).</p>
<b>Ndikimi</b>	Kjo gjendje rezulton me pak fonde nga të hyrat dhe ulë mundësin që të realizohen obligimet ndaj kreditorëve apo mbulimin e shpenzimeve për NSH që janë në proces të likuidimit.
<b>Rekomandimi B2</b>	Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë që mekanizmat e kontrollit e monitorojnë dhe i shtojnë kontrollet tek qiramarrësit që vonohen në kryerjen e pagesave të qirasë në mënyrë që arkëtimi i të hyrave të bëhet në kohë.

### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

### 3 Informacion i përmbledhur për pranimet dhe pagesat e Fondeve në Mirëbesim

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelën e mëposhtme;

**Tabela 1. Pasqyra e pranimeve dhe pagesave për vitet 2021 dhe 2022 në Euro (€)**


Përshkrimi	Pranimet/Pagesat Janar-Dhjetor 2021	Gjendja e llogarive me 31 dhjetor 2021	Pranimet/Pagesat Janar-Dhjetor 2022	Gjendja e llogarive me 31 dhjetor 2022
<b>PRANIMET NË LLOGARITË BANKARE</b>				
<b>Gjithsej PRANIMET NË LLOGARITË BANKARE</b>	<b>11,381,018</b>	<b>26,853,273</b>	<b>11,498,674</b>	<b>38,351,947</b>
Të hyrat nga shitja e asetëve	6,096,934	20,919,232	6,152,060	27,071,292
Të hyrat nga qiraja	5,130,354	8,334,993	4,842,279	13,177,272
Interesi i fituar	0	0	0	0
Të hyrat nga tarifa dhe konfiskimet e Bid Depozitave në tenderët e shitjes	5,400	96,700	111,501	208,201
Bid depozitat për Pjesëmarrje në Tender	0	-2,746,489	211,000	-2,535,489
Të hyra tjera	148,331	248,837	181,834	430,671
Kapitali themeltar i Agjencisë Kosovare të Privatizimit	0	0	0	0
<b>PAGESAT/SHPËRNDARJA NGA LLOGARITË</b>				
<b>Gjithsej PAGESAT/SHPËRNDARJA NGA LLOGARITË</b>	<b>18,101,296</b>	<b>117,275,570</b>	<b>30,381,309</b>	<b>147,656,879</b>
20% i punëtorëve transferuar në BSPK	3,702,049	20,203,456	6,673,827	26,877,283
Ofruesi i Shërbimeve Profesionale (Autoritetet e Likuidimit)	358,250	839,118	429,900	1,269,018
Mallra dhe shërbime	2,325,689	4,473,380	1,800,553	6,273,933
Shpenzimet komunale	233,222	417,373	206,836	624,209
Tatimet	3,314,863	4,090,877	819,098	4,909,975
Vendimet e gjykatave/përmbauesve (depozita dhe taksa)	213,165	599,451	5,366,632	5,966,083
Transferimi i mjeteve 5% për mbulimin e aktiviteteve të AKP-së	0	0	0	0
Të tjera	39,322	52,551	13,478	66,028
Pagesat ndaj kreditorëve të NSh-së	7,876,181	15,084,626	15,070,985	30,155,611
Fondet transferuar Buxhetit të Kosovës	38,555	71,514,738	0	71,514,738
<b>Gjendja bankare</b>	<b>-6,720,278</b>	<b>-90,422,297</b>	<b>-18,882,635</b>	<b>-109,304,932</b>




Pranimet/të hyrat kanë të bëjnë me shitjet, qiratë e aseteve të NSh-ve dhe të hyrat tjera. Gjatë vitit 2022 pranimet/të hyrat ishin 11,498,674€, në raport me vitin e kaluar 11,381,018€ kemi një rritje prej 1.03%.

Pagesat/shpërndarjet gjatë vitit 2022 ishin (30,381,309€), në raport me vitin e kaluar (18,101,296€) kemi një rritje prej 67.84%€.

Grafiku 1. Pranimet sipas kategorive ekonomike gjatë periudhës 2021-2022



Grafiku 2. Pagesat sipas kategorive ekonomike gjatë periudhës 2021-2022



## 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2021 të Fondeve në Mirëbesim ka rezultuar në gjashtë (6) rekomandime. FM kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatohet rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2022, dy (2) rekomandime ishin zbatuar ndërsa dy (2) rekomandime nuk ishin zbatuar, përderisa dy (2) pjesërisht të zbatuara. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

**Grafiku 3. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak**




Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2021	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për konkluzion	Bordi i Drejtorëve të AKP-së duhet të shtoj kontrollin e brendshëm lidhur me arkëtimin e të hyrave nga shitja e aseteve me negociim direkt si dhe të ndërmer veprimet e duhura në rastet kur pagesat nuk arkëtohen brenda afateve.	Nuk janë ndërmarrë veprimet e duhura për adresimin e këtij rekomandimi.	Nuk ka filluar zbatimin
2.	Baza për konkluzion	Bordi i Drejtorëve të AKP-së duhet të sigurojë se obligimet ndaj furnitorëve paguhen brenda afatit ligjor, si dhe të respektohen vendimet e bordit dhe kërkesat tjera në realizimin e pagesave.	Gjatë vitit 2022 nuk kemi hasur në raste të tilla.	I zbatuar
3.	Të hyrat	Bordi i Drejtorëve të AKP-së përmes Drejtorit Menaxhues duhet të sigurojë që mekanizmat e kontrollit, e monitorojnë dhe i shtojnë kontrollet tek qiramarrësit që vonohen në kryerjen e pagesave të qirasë në mënyrë që arkëtimin i të hyrave të bëhet me kohë.	Ende ka vonesa në arkëtimin e të hyrave nga Qiratë. Kjo çështje është trajtuar në brendi të raportit (B2).	Nuk ka filluar zbatimin
4.	Të hyrat nga qiraja	Bordi i Drejtorëve të AKP-së duhet të sigurojë se kontrollet e vendosura bazuar në rregullat në fuqi, janë duke u zbatuar. Monitorimi i aktiviteteve të autoritetit të likuidimit të fuqizohet me qëllimin që çdo ndryshim i çmimit të qirasë të përcillet paraprakisht, për miratim të Bordit.	Gjatë vitit 2022 nuk kemi hasur në raste të tilla.	I zbatuar
5.	Mallra dhe shërbime	Bordi i Drejtorëve të AKP-së të sigurojë se kontrollet e vendosura funksionojnë dhe monitorimi nga nivelet përkatës realizohet duke u siguruar se periudha e angazhimit të OSh fillon pas pajtimit të palëve/ apo nënshkrimi i palëve i paraprin periudhën e angazhimit sipas marrëveshjes. Gjithashtu, të sigurojë trajtim të barabartë gjatë angazhimit të OSh-ve.	Për shkak se me rregulloren e brendshme për ofruesit e shërbimeve nuk parashohin kufizime sa i përket moshës e kemi trajtuar si çështje të mbyllur.	I zbatuar
6.	Mallra dhe shërbime	Bordi i Drejtorëve të AKP-së duhet të sigurohet se kostot e angazhimit sipas Rregullores 06/2021 janë duke u zbatuar, duke pas parasysh pagesën e njëjtë për shërbimin e njëjtë, në të kundërt në pa mundësi të zbatimit të këtyre çmimeve të gjendur mundësia e përditësimit të kësaj rregullore, duke pas parasysh implikimet financiare dhe ruajtjen e fondeve të NSh në likuidim.	Edhe gjatë vitit 2022 pagat e OSH -ve bien ndesh me rregullorën për përcaktimin e kostove të angazhimit të Osh-ve.	Pjesërisht i zbatuar


Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Agron Fetiu, Ndhmës Auditor i Përgjithshëm



Jusuf Kryeziu, Drejtor i Auditimit



Valbona Tolaj, Udhëheqëse e ekipit



Luljeta Morina, Anëtare e ekipit



## Shtojca I: Letër konfirmimi

## Letërkonfirmimi

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT - KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU	
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO	
II	
Nr. Br.:	2184
Nr. i Fq. Sc. Nr. No. Pg.:	A
Data:	22 JUN 2023
Prishtinë / Pristina	

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT  
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU  
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

## LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2022 dhe për zbatimin e rekomandimeve.

Për: **Vlora Spanca**  
Auditore e Përgjithshme  
Zyra Kombëtare e Auditimit


REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO			
AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT - KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU			
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO			
Zyra Kombëtare e Auditimit			
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE			
23.06.2023			
Emri i Org. / Org. Unit	Sht. Klasif. / Klassif. Kod	Nr. Prot. / Br. Prot.	Emri i Org. / Br. Shtetsh.
05	47	1040	1

E nderuar znj. Spanca,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- Kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Fondeve në Mirëbesim, për vitin 2022 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- Pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- Brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Me respekt,

  
**Arben Limani**  
Drejtor Menaxhues  
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +383 (0) 38 500 400  
Faks: +383 (0) 38 248 076

Email: [info@pak-ks.org](mailto:info@pak-ks.org)  
[www.pak-ks.org](http://www.pak-ks.org)

Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë  
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

## Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare<sup>6</sup> duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet<sup>7</sup>, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

### Forma e opinionit

#### Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

### Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

### Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

### Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.



**Mohim i opinionit**

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

**Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit**

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

## Shënimet fundore

- <sup>1</sup> Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- <sup>2</sup> Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- <sup>3</sup> Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- <sup>4</sup> Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja  
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura  
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- <sup>5</sup> Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- <sup>6</sup> Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- <sup>7</sup> Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.